



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 24.12.2019)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:20 dhe mbaroi në orën 12:27.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Brikena Ukperaj.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

2. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpërndarjen e automjeteve të reja dhe atyre në përdorim, në sistemin gjyqësor”.

Naureda Llagami: Atëherë, fillojmë mbledhjen e radhës të datës 24.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Janë të pranishëm të gjithë anëtarët, përveç zonjës Ukperaj e cila është me leje.

Siç kemi parashikuar në rendin e ditës, sot është shqyrtimi i projektvendimit për shpërndarjen e automjeteve të reja dhe atyre në përdorim, në sistemin gjyqësor.

Atëherë, në vijim të këtij projekt-akti i cili është një propozim i Komisionit të Planifikimit Strategjik, dëshiroj t’ju informoj që Komisioni ka shqyrtuar nevojat që kemi aktualisht brenda KLGJ-së si dhe atyre të gjykatave.

Pas realizimit të procedurave të prokurimit dhe ekzekutimit të kontratës së blerjes, janë lëvruar 22 automjete të reja (vit prodhimi 2019). Kanë paraqitur kërkesat për t’u pajisur me automjet të ri 17 gjykata.

Në inventarin e disponuar, gjykatat e të tre niveleve kanë gjithsej 94 automjete. Rreth 40 mjete janë prodhim i vitit 1990-2003, që janë aktualisht të amortizuar në aspektin kontabël; 2 gjykata administrative të shkallës së parë Tiranë dhe Durrës, aktualisht nuk kanë një automjet në dispozicion për të përmbushur nevojat e tyre në fushën e transportit; 6 gjykata në rrethet gjyqësore kanë të paktën 1 mjet në dispozicion (prodhim i viteve 95-2003) dhe këto në gjendje jo të mirë teknike; Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda (aktualisht Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar) ka kërkuar të pajiset me 3 automjete; KLGJ-ja ka në pronësinë e saj gjithsej 7 automjete, prej të cilave janë në gjendje teknike për t’u transferuar rreth 6 automjete.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit ka bërë propozimin konkret lidhur me ndarjen e automjeteve të përdorura, ashtu edhe shpërndarjen e makinave që janë aktualisht në përdorim të KLGJ-së. Nëse kërkoni më shumë informacion, zonja Laze është këtu e pranishme për të na detajuar dhe sqaruar çfarëdo lloj paqartësie që ju mund të keni lidhur me këtë propozim.

Konkretisht propozimi është: Shpërndarja e automjeteve të reja, në sistemin gjyqësor, do jetë si më poshtë:

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor është menduar që të jenë 13 automjete të reja; Për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të transferohen 3 automjete; Për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të transferohet 1 automjet; Për Gjykatën e Apelit Gjirokastër të transferohet 1 (një) automjet; Për Gjykatën e Apelit Korçë të transferohet 1 automjet; Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të transferohet 1 automjet; Për Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të transferohet 1 automjet; Dhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec të transferohet 1 automjet.

Ndërkohë, shpërndarja e automjeteve që aktualisht janë në përdorim (pronësi) të KLGJ-së, të bëhet si më poshtë: Në Gjykatën e Apelit Tiranë të transferohet 1 automjet; Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë të transferohet 1 automjet; Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë të transferohet 1 automjet; Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës të transferohet 1 automjet; Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje, të transferohet 1 automjet; Së fundi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, të transferohet 1 automjet.

Ky është edhe propozimi i bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Luljeta Laze: Meqenëse bëme diferencën që do të mbajë 13 automjete KLGJ-ja, kemi shtuar për të dhënë një automjet të ri Gjykatës Pogradec, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, meqenëse nuk ka një automjet ajo sot dhe mjetin që kishim parashikuar për të përdorur për Gjykatën Pogradec, kemi menduar që të plotësohet nevoja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Naureda Llagami: E kemi reflektuar.

Luli ka të drejtë, se kur kemi bërë dje diskutimin tek Komisioni, nuk ka qenë e përfshirë. Ndërkohë që me ndryshimet që bëme më pas, është përfshirë edhe Gjykata e

Rrethit Gjyqësor Kavajë, që t'i transferohet një automjet.

Ndonjë diskutim?

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: I. Shpërndarjen e automjeteve të reja, në sistemin gjyqësor, si më poshtë: 1. Në Këshillin e Lartë Gjyqësor, të qëndrojnë 13 (trembëdhjetë) automjete; 2. Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të transferohen 3 (tre) automjete; 3. Në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të transferohet 1 (një) automjet; 4. Në Gjykatën e Apelit Gjirokastër të transferohet 1 (një) automjet; 5. Në Gjykatën e Apelit Korçë të transferohet 1 (një) automjet; 6. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të transferohet 1 (një) automjet; 7. Në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të transferohet 1 (një) automjet; 8. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec të transferohet 1 (një) automjet; II. Shpërndarjen e automjeteve që aktualisht janë në përdorim (pronësi) të KLGJ-së, si më poshtë: 1. Në Gjykatën e Apelit Tiranë të transferohet 1 (një) automjet; 2. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë të transferohet 1 (një) automjet; 3. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë të transferohet 1 (një) automjet; 4. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës të transferohet 1 (një) automjet; 5. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje, të transferohet 1 (një) automjet; 6. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, të transferohet 1 (një) automjet. III. Me zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq, mbledhjen e sotshme e konsideroj të mbyllur.

Faleminderit për prezencën.

Punë të mbarë!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor